

Rregullimi i Procedurës dhe të Dhënat Disiplinore në Komunën e Gjakovës 2022-2023

Hyrje

Ndërtimi i një administrate lokale transparente dhe llogaridhënëse dhe me integritet është njëri nga synimet kryesore të Republikës së Kosovës. Megjithatë, në veçanti integriteti në shërbimin publik vazhdon të mbetet sfida. Në nivel komunal evidentohet nevoja për të promovuar hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit në shërbimin publik si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës.¹

Për ta arritur këtë qëllim përpos llogaridhënies para publikut, institucionet e Kosovës kanë ndërtuar mekanizma konkret, të cilët kërkojnë llogari nga nëpunësit në procedurat administrative duke mos përjashtuar edhe procedurën penale në rastet kur shkeljet sanksionohen me Kodin Penal.

Mekanizma të llogaridhënies për zyrtarët publikë në Republikën e Kosovës janë vlerësimi i performancës dhe në veçanti procedurat disiplinore.

Për këtë qëllim, komunat kanë hartuar kodet e etikës ndërsa Qeveria e Kosovës ka miratuar rregulloren përkatëse për disiplinë.

BIRN në hulumtime paraprake kishte konstatuar se një numër i vogël i zyrtarëve të nivelit lokal përfshihen në procedura disiplinore për shkeljet e kryera gjatë punës.

Me qëllim të dokumentimit të kuptimit të arsyeve pse në vend ka numër të vogël të procedurave disiplinore, BIRN ka realizuar pesë hulumtime në komuna të ndryshme të vendit për të matur nivelin e edukimit për disiplinën dhe nivelin e zbatimit të procedurave dhe kodit të etikës në komunat përkatëse.

Në Komunën e Gjakovës BIRN ka gjetur se:

- Komuna ka hartuar Kodin e Etikës i cili nuk i zbaton standardet europiane për procedurat disiplinore për të emëruarit politikë;
- Kodi i Etikës përmban kufizime për lirinë politike të të emëruarve politikë;
- Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë fushatë/aktivitet për të informuar qytetarët e saj për të drejtën e tyre për të iniciuar ankesë ndaj zyrtarit komunal kur ka pretendime për shkelje disiplinore;

¹ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2023, i qasshëm në linkun - https://integrimievropian.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf

- Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë promovim të hapur për qytetarët lidhur me miratimin e Kodit të Etikës;
- BIRN ka identifikuar probleme të theksuara në njohjen e fushave nga procedura disiplinore dhe ajo e konfliktit të interesit;
- Të gjitha procedurat disiplinore janë hapur sipas detyrës zyrtare nga mbikëqyrësit ose me ankesë të zyrtarëve komunale kurse nuk ka procedura të cilat janë iniciuar nga qytetarët apo organizatat e shoqërisë civile;
- Komuna nuk ka të përcaktuar rregulla specifike për kompensimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore brenda komunës;
- Anëtarët e Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës nuk i janë nënshtruar trajnimit paraprakisht para përzgjedhjes së tyre;
- BIRN ka identifikuar mungesë të trajnimeve të vazhdueshme për anëtarët e Komisionit Disiplinor; BIRN ka identifikuar mungesë të një mekanizmi mbikëqyrës ndaj cilësisë së punës së Komisionit Disiplinor – në veçanti politikën ndëshkimore disiplinore të komisioneve disiplinore.

Metodologjia

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara në mes muajve shkurt dhe mars, duke përdorur tri forma të grumbullimit të të dhënave.

BIRN në metodologji ka përcaktuar qëllimet e hulumtimit duke i grupuar ato në tri shtylla:

- Niveli i Edukimit mbi Etikën dhe Disiplinën në komunë
- Analizimin e bazës ligjore të rregullimit të etikës dhe disiplinës
- Zbatimin në praktikë i kodeve të etikës dhe rregullave disiplinore

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë grumbulluar të shtrira në tri faza hulumtuese.

Në fazën e parë, BIRN ka realizuar një takim informues me zyrtarë të Komunës së Gjakovës dhe gjatë takimit janë marrë të dhëna paraprake për përgatitjen e fazës së dytë. Në fazën e parë, BIRN po ashtu ka analizuar bazën ligjore të rregullimit të etikës dhe disiplinës në komunë në raport me kërkesat që përcaktohen në standardet europiane të qeverisjes së mirë lokale.

Të dhënat nga faza e parë janë përdorur për të zhvilluar gjetjet e këtij raporti por edhe për të hartuar një pyetësor me 17 pyetje hulumtuese për zyrtarët komunalë të cilët janë përfshirë në studim.

Faza e dytë ka korresponduar me një matje në terren për të testuar njohuritë e zyrtarëve komunalë mbi kodin e etikës dhe procedurën disiplinore.

10 zyrtarë komunalë të përzgjedhur nga komuna i janë nënshtruar një procesi të testimit me 17 pyetje të përgatitura nga BIRN, e të cilat përmbajnë informacione për kodin e etikës dhe kodin e procedurës disiplinore.

Testimi është realizuar në prani të hulumtuesve të BIRN dhe zyrtarëve të komunës.

Zyrtarët e përfshirë në këtë studim ishin nga drejtoritë e Prokurimit, Financave, Administratës, Arsimit, Shëndetësisë. Identiteti i tyre është mbajtur i fshehur për qëllime të mbrojtjes së privatësisë.

Në fazën e tretë të hulumtimit, BIRN ka pranuar nga komuna përgjigjet në 12 pyetje hulumtuese nga të cilat janë mbledhur të dhëna për:

- Numrin e ankesave disiplinore;
- Numrin e ankesave ex-officio disiplinore;
- Numrin e vërejtjeve nga menaxherët e linjës;
- Numrin e vërejtjeve dhe sanksioneve disiplinore nga komisionet përkatëse;
- Numrin e ankesave të hedhura poshtë nga institucionet, si Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil;
- Përdorimin e teknologjisë informative për të kontrolluar disiplinën (sistemi i burimeve njerëzore SIMBN). Sa përdoret ky sistem? A kanë njohuri për përdorim të këtij sistemi;

Për këtë fushë ka realizuar edhe një intervistë të thellë me Udhëheqësin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, e cila korrespondon me mbi 30 pyetje hulumtuese. Të dhënat nga statistikat dhe intervista e thellë do të paraqiten në vazhdimësi gjatë këtij raporti.

Gjetjet kryesore

Komuna ka hartuar Kodin e Etikës, i cili nuk i zbaton standardet europiane për procedurat disiplinore për të emëruarit politikë

Komuna e Gjakovës ka të themeluara dy komisione disiplinore, Komisionin Disiplinor për Nëpunësit Civil dhe Komisionin Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik. Të dyja këto komisione përbëhen nga tre anëtarë dhe në përbërje kanë së paku nga një jurist siç e parasheh edhe Ligji për Zyrtarët Publikë 08/L-197². Po ashtu, Komuna e Gjakovës ka në zbatim Kodin e Etikës të cilin e ka miratuar në shtator të vitit 2022.

Në bazë të nenit 2 të këtij Kodi, në të cilin parashihet fushëveprimi i Kodit, aty theksohet se dispozitat e Kodit zbatohen për të gjithë zyrtarët e komunës gjatë ushtrimit të funksioneve, detyrave ose kompetencave publike.³

Megjithatë, në nenin 32 “Masat Disiplinore” parashihet që masat disiplinore shqiptohen ndaj zyrtarëve publikë.

“Zyrtari publik që shkel dispozitat e përcaktuara në këtë Kod dhe veprimet e tij/saj nuk përbejnë ve për penale, ndëshkohen me masat disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

² Ligji për Zyrtarët Publik i qasshëm në linkun - <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

³ Kodi i Etikës së Komunës së Gjakovës, i qasshëm në <https://kk.rks-gov.net/gjakove/ep-content/uploads/sites/2/2022/10/Kodi-i-Etikes-ne-Komunen-e-Gjakoves.pdf>

Se çka nënkupton shprehja zyrtar publik sipas Kodit të Etikës, saktësisht në nenin 3 tek pjesa “Përkufizimet” thuhet “*Zyrtari publik - përfshin zyrtarët siç përcaktohet në paragrafin 2 i nenit 2 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë*”.

Neni 2 i Ligjit 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, paragrafi i dytë përfshinë edhe nëpunës të kabinetit dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës.

*“2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil);
2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik;
2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe
2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.”*

Kjo çështje nuk ka arritur të adresojë në tërësi kërkesat dhe standardet europiane të qeverisjes së mirë lokale.⁴

Megjithatë, Rregullorja për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë 11/2020 dhe Rregullorja për Disiplinën e Nëpunësve Civilë 01/2024 që ka shfuqizuar rregulloren paraprake, e që derivon nga Ligji për Zyrtarët Publikë 08/L-197, përjashton të zgjedhurit, të emëruarit politikë dhe zyrtarët e kabinetit.

Kjo nënkupton se edhe pse Kodi i Komunës së Gjakovës ka paraparë edhe zyrtarët politikë komunalë t’i nënshtrohen përcaktimeve të këtij Kodi, nuk është përcaktuar ndonjë procedurë specifike e rregulluar dhe efikase disiplinore për ta.

Pra, nuk ka asnjë përcaktim lidhur me procedurën që ata mund t’i nënshtrohen në rast se sjellja e tyre bie ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës.

Por, Kodi i Etikës së Komunës së Gjakovës parasheh se Kryetari i Komunës është autoriteti i cili bën thirrje nga të emëruarit politikë të respektojnë parimet e sjelljes të përcaktuara në Kod. Pra “thirrja” nga kryetari është obligimi që të emëruarit politikë kanë për zbatimin e kodit.

Neni 33 –“Zbatimi i kodit dhe masave disiplinore për të zgjedhurit dhe të emëruarit politik” / Kryetari i komunës do të bëjë thirrje dhe kërkojë nga të emëruarit politik të respektojnë parimet e sjelljes të përcaktuara në Kodin e Etikës...“Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i Komunës do të monitorojë me kujdes maksimal zbatimin e parimeve të përcaktuara në këtë Kod, duke paralajmëruar në çdo kohë për detyrimet për të vepruar në përputhje me Kodin”

Mungesën e procedurës disiplinore dhe pamundësinë për shqiptimin e masave për të emëruarit politikë e konfirmon edhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore për Komunën e Gjakovës, Kushtrim Brahimaj.

“Kodi i etikës nuk parasheh masa sanksionuese ndaj të emëruarve politikë. Kjo për fatin tonë e kemi hequr në momentin e fundit. Marrëdhënia e punës e të emëruarve politikë është marrëdhënie me titullarin e tyre, në rastin konkret me Kryetarin e Komunës. Është në

⁴ Strategjia për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal e qasshme në linkun - [1680746f16 \(coe.int\)](https://www.coe.int)

ekskluzivitetin e kryetarit të ndërmarrë veprime ose të mos ndërmarrë veprime. Për këtë arsye ne e kemi vendosur etikën e të emëruarve politikë në Kod por jo sanksionet, d.m.th. “Qysh duhet me bo ata por jo çka ndodh nëse s’i bëni” tha Brahimaj⁵.

Strategjia për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal⁶ e Këshillit të Europës ka paraparë parimet e qeverisjes së mirë në nivel lokal. Parimi i gjashtë i kësaj Strategjie parasheh sjelljen etike që pritet edhe nga zyrtarët e zgjedhur dhe politikë.

Kodi i Etikës së Komunës së Gjakovës nuk ka arritur të përcaktojë procedura të rregulluara dhe efikase për të zyrtarët politikë.

Kodi i etikës ka kufizime të cilat bien ndesh të drejtat politike

Kodi i Etikës së Komunës së Gjakovës në nenin 5 “*Respektimi i vullnetit zgjedhor të qytetarëve*”, ka paraparë kushtëzime të cilat nuk kanë asnjë mbështetje ligjore dhe për më tepër kufizojnë të drejtat dhe liritë politike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet relevante për zgjedhjet dhe qeverisjen lokale, nuk kanë përcaktuar ndonjë kufizim për ndërrimin e subjektit politik të cilit i takojnë.

“Zyrtari politik duhet të respektojë vullnetin e votuesve deri në fund të mandatit.”, përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 5 të Kodit të Etikës.

Ky përcaktim i Kodit të Etikës i dedikohet ekskluzivisht zyrtarëve komunalë politikë dhe urdhëron “duhet”, të respektohet vullneti i votuesve deri në fund të mandatit.

Përderisa sistemi elektoral me lista të hapura dhe me një zonë zgjedhore nuk e ndalon ndryshimin e përfaqësimit politik të anëtarëve të kuvendit dhe gjithashtu mandati i anëtarit të kuvendit i takon atij, është shkelje ligjore që nëpërmes Kodit t’i ndalohet lëvizjet brenda grupeve të përfaqësuara në kuvend.

Ligji për vetëqeverisje lokale nuk i njeh partitë politike (grupet politike) si entitet të veçantë politik por e trajton mandatin e anëtarit të kuvendit si trupë e veçantë përfaqësuese.

Përderisa komunat kanë të drejtën e plotë që të përcaktojnë sjelljet që duhet të shmangen dhe sjelljet që priten nga zyrtarët komunalë, në asnjë rrethanë nuk mund të vendosin kufizime që cenojnë lirinë e përcaktimit politik të zyrtarëve politikë.

⁵ Intervista e realizuar nga BIRN me z. Kushtrim Brahimaj, Udhëheqës i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, datë 12 mars 2024.

⁶ Strategjia për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal e qasshme në linkun - [1680746f16 \(coe.int\)](https://www.coe.int)

Mungesa e aktiviteteve njoftuese rreth Kodit të Etikës për qytetarët

Komuna e Gjakovës përveç se e ka të publikuar Kodin e Etikës në ueb-faqen e Komunës, nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim tjetër ⁷ për të njoftuar qytetarët e Gjakovës lidhur me Kodin e Etikës si dokument, si dhe me të drejtën e tyre për të iniciuar kërkesë për inicim të procedurës ndaj zyrtarëve të komunës, procedurat që duhet ndjekur, afatet e parashkrimit të shkeljeve dhe çështjet tjera që ndërlidhen me procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve komunalë.

Viti	Numri i ankesave të paraqitura nga qytetarët ndaj zyrtarëve të Komunës
2022	0
2023	0

Të dhënat e paraqitura në tabelë më lartë pasqyrojnë sesi qytetarët në Komunën e Gjakovës nuk kanë paraqitur asnjë rast të vetëm në dy vitet e fundit për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarëve komunalë.

Aktivitetet njoftuese rreth Kodit të Etikës për zyrtarët

Numri i nëpunësve civilë në Administratën e Komunës së Gjakovës është 229 zyrtarë ndërsa numri i stafit politik është gjithsej 25 zyrtarë.

Numri i nëpunësve civil	Numri i nëpunësve të shërbimit publik	Numri i performuesve të artit	Numri i stafit mbështetës
229	1727	22	273

Numri i stafit politik në Komunën e Gjakovës	25
--	----

Kodi i Etikës është njëri nga dokumentet me të cilin njoftohen të gjithë zyrtarët e Komunës të cilët po ashtu nënshkruajnë edhe një deklaratë zotimi. Komuna e Gjakovës ka ndërmarrë trajnime hyrëse ⁸ për secilin zyrtar që është punësuar 3 vitet e fundit në bashkëpunim me IKAP-in që përfshijnë 1/3 e të gjithë zyrtarëve në komunë, për t'i njoftuar zyrtarët komunalë lidhur me rregullimin ligjor dhe nënligjor lidhur me disiplinën.

Kurse me hyrjen në fuqi të Kodit, Njësia e Burimeve Njerëzore në procese të ndara përmes komunikimit me e-mail ka përcjellë tek secili zyrtar për fusha të ndara ato që përcakton Kodi dhe Rregullorja për Disiplinë.⁹

⁷ Intervista e realizuar nga BIRN me z. Kushtrim Brahimaj, Udhëheqës i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, datë 12 mars 2024.

⁸ Intervista e realizuar nga BIRN me z. Kushtrim Brahimaj, Udhëheqës i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, datë 12.03.2024

⁹ Intervista e realizuar nga BIRN me z. Kushtrim Brahimaj, Udhëheqës i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, datë 12.03.2024

Numri i ankesave të paraqitura në Komisionet Disiplinore gjatë viteve 2022-2023

Viti	Numri i Procedurave disiplinore të zhvilluara për nëpunës të shërbimit civil	Numri i Procedurave disiplinore të zhvilluara për nëpunës të shërbimit publik
2022	5	9
2023	6	15

Mënyra e zgjidhjes së rasteve

Mënyra e zgjidhjes së rasteve disiplinore	Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik
2022	<ul style="list-style-type: none"> - Një ndalesë 20% të pagës për dy muaj është shqiptuar për nëpunësit e Shërbimit Civil; - Një procedurë është pezulluar deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të Gjykatës; - Tri kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore janë refuzuar; 	<ul style="list-style-type: none"> - Një ndalesë 40% të pagës për tre muaj është shqiptuar për nëpunësit e Shërbimit Publik; - Një pezullim është shqiptuar për nëpunësit e Shërbimit e Publik; - Tri ndalesa 20% të pagës për një muaj janë shqiptuar për nëpunësit e Shërbimit Publik; - Në një procedurë është shqiptuar masa ndërrim i vendit të punës për nëpunësit e Shërbimit Publik - Një ndalesë 20% të pagës për dy muaj është shqiptuar për nëpunësit e Shërbimit Publik; - Një masë largim nga shërbimi publik është shqiptuar për nëpunësit e Shërbimit Publik; - Një ndalesë 20% të pagës për dy muaj janë shqiptuar për nëpunësit e Shërbimit Publik

<p>2023</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Një masë për pezullim të përkohshëm është shqiptuar për nëpunësin e shërbimit civil; - Një masë ndalesë 20% të pagës për një muaj është shqiptuar për nëpunësin e shërbimit civil; - Një masë ndalesë 30% të pagës për tre muaj është shqiptuar për nëpunësin e shërbimit civil; - Tri kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore janë refuzuar për nëpunësit e shërbimit civil. 	<ul style="list-style-type: none"> - Tre masa ndalesë 20% të pagës për tre muaj janë shqiptuar për nëpunësit e shërbimit publik; - Një masë disiplinore ulje në pozitë është shqiptuar për nëpunësin e shërbimit publik; - Dy masa largim nga shërbimi publik janë shqiptuar për nëpunësit e shërbimit publik; - Katër kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore janë refuzuar për nëpunësit e shërbimit publik; - Një masë ndalesë 40% të pagës për dy muaj është shqiptuar për nëpunësin e shërbimit publik; - Një masë ndalesë 40% të pagës për tre muaj është shqiptuar për nëpunësin e shërbimit publik; - Dy masa pezullime janë shqiptuar për nëpunësit e shërbimit publik; - Në një procedurë Komisioni është shpallur jo kompetent për shqyrtim dhe vendosje.
-------------	--	--

Kjo tabelë pasqyron të dhënat lidhur me llojin e masave të shqiptuara nga dy Komisionet Disiplinore; Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik dhe Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Komunën e Gjakovës.

Këto të dhëna pasqyrojnë se në vitin 2023 këto Komisione kanë pranuar dhe shqyrtuar gjithsej 21 lëndë.

7 kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore janë refuzuar si të pabazuara, 3 kërkesa kanë rezultuar me ndalesë 20% të pagës për tre muaj, 1 ulje në pozitë, 1 ndalesë 40% të pagës për tre muaj, 2 pezullime deri në vendosje të Gjykatës, 1 ndalesë 40% të pagës për dy muaj, 1 ndalesë 20% të pagës për dy muaj, 2 largime nga shërbimi publik, 1 pezullim i përkohshëm, 1

ndalesë 30% të pagës për tre muaj dhe në 1 procedurë Komisioni është shpallur jokompetent për shqyrtim dhe vendosje.

Gjatë procedurave disiplinore, Komuna e Gjakovës ka pasur dy raste kur anëtarët e komisionit disiplinor me qëllim të shmangies së mundshme të konfliktit të interesit janë tërhequr nga vendimmarrja.

Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik dhe Nëpunësit Teknikë dhe Mbështetës në Komunën e Gjakovës

Viti	Numri i Ankesave të dorëzuara	Numri i ankesave të refuzuara	Numri i ankesave të aprovuara	Koment
2022	27	23	3	1 – është shpallur jokompetent
2023	24	21	2	1 – është aprovuar pjesërisht

Sipas të dhënave që pasqyron kjo tabelë, rezulton se në dy vitet e fundit në Komisionin e Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik dhe Nëpunësit Teknikë dhe Mbështetës në Komunën e Gjakovës janë dorëzuar gjithsej 51 ankesa, prej tyre 44 janë refuzuar kurse janë aprovuar vetëm 5.

Ankesat e paraqitura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Viti	Numri i Ankesave të trajtuara	Numri i ankesave të hedhura poshtë	Numri i ankesave të aprovuara	Numri i ankesave të refuzuara	Raste kur është shpallur jokompetent	Raste kur ka nxjerrë vendim për përfundim të procedimit administrativ	Raste kur ka nxjerrë vendim për anulim të rezultateve të vlerësimit
2022	37	2	19	7	6	2	1
2023	25	5	2	4	1	13	0

Sipas të dhënave të marra nga Komuna e Gjakovës, rezulton se 62 Shërbyes Civil të kësaj komune i janë drejtuar me ankesë ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor përgjatë dy viteve të fundit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Nga 62 ankesa të dorëzuara, 21 janë aprovuar, janë refuzuar 11 ankesa, kurse janë hedhur poshtë 10 ankesa.

Të dhënat nga pyetësorët

Me qëllim të pasqyrimin të njohjes së disa prej koncepteve bazike lidhur me Kodin e Etikës së Komunës dhe Rregullores për Disiplinë për Nëpunësit Civil, BIRN ka zhvilluar pyetësorin për

zyrtarët e Komunës së Gjakovës të cilët janë përzgjedhur në mënyrë rastësore ndërsa të dhënat që mund të identifikojnë pjesëmarrësit në pyetësor nuk janë kërkuar.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të zyrtarëve pjesëmarrës në pyetësor

1 zyrtar	0 deri 1 vjet
5 zyrtarë	1 deri 5 vjet
3 zyrtarë	5 deri 10 vjet
1 zyrtar	Më shumë se 10 vjet

Pyetjet dhe përgjigjet e zyrtarëve lidhur me Kodin e Etikës

Pyetja	Saktë	Pjesërisht Saktë	Pasaktë
1. Ndaj kujt zbatohet Kodi i Etikës së Komunës?	4	6	0
2. Sa është shuma e dhuratave që mund të pranojnë zyrtarët në punën e tyre?	9	0	1
3. Kujt duhet t'i raportoni për pranimin e dhuratave	9	0	1
4. Çka nënkupton situata e konfliktit të interesit?	5	0	5
5. Konfidencialiteti pas përfundimit të marrëdhënies së punës	5	0	5
6. Sa anëtarë ka komisioni disiplinor?	6	0	4
7. A lejohet pjesëmarrja në vendimmarrje për të disiplinuar, ngritur në detyrë, disiplinuar apo shkarkuar personin e afërm	10	0	0
8. Përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Etikës dhe njoftimit është Njësia e Burimeve Njerëzore?	10	0	0

Nga të dhënat e pyetësorëve të realizuar, rezulton se zyrtarët kanë njohuri lidhur me konceptin e nepotizmit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, pranimin e dhuratave e raportimit të tyre, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kodit të etikës.

50% e zyrtarëve të intervistuar nuk kanë pasur njohuri lidhur me konceptin e konfliktit të interesit si dhe me detyrimet e ruajtjes së konfidencialitetit pas përfundimit të marrëdhënies së punës.

Trajnimet e zyrtarëve komunalë lidhur me Kodin e Etikës apo Rregulloren për Disiplinë

Asnjë deri më tani	4 zyrtarë
--------------------	-----------

1 trajnim	5 zyrtarë
2 trajnime	1 zyrtar
3 trajnime	0 zyrtarë

Kodi i Etikës së Komunës së Gjakovës parasheh që për trajnimin e zyrtarëve të saj, përgjegjëse është Njësia për Menaxhimin e Burimeve njerëzore.¹⁰ Nga 10 zyrtarë të intervistuar me pyetësor, 4 nga ta kanë deklaruar se nuk është zhvilluar asnjë trajnim ndaj tyre lidhur me Kodin e Etikës apo Rregullores për Disiplinë, kurse 5 zyrtarë kanë deklaruar se është zhvilluar një trajnim ndaj tyre, kurse 1 ka deklaruar se janë zhvilluar 2 trajnime ndaj tij.

Pyetjet dhe përgjigjet e zyrtarëve komunalë lidhur me Rregullat dhe procedurën disiplinore

Pyetja	Saktë	Pjesërisht Saktë	Pasaktë
1. Kush është kompetent për shqiptimin e masave disiplinore?	3	6	1
2. Me rastin e shqiptimit të masës disiplinore merren parasysh edhe përpjekjet për zvogëlimin e dëmit?	6	0	4
3. Sa është afati për ankesë ndaj vendimit disiplinor?	3	0	7
4. Shkelja e përsëritur e rregullave të Kodit të Etikës konsiderohet si shkelje e lehtë?	7	0	3
5. Kush e shqipton masën “ndalimi i ngritjes në detyrë”?	5	0	5
6. Afati i parashkrimit të shkeljeve të lehta është 3 vjet kurse i shkeljeve të rënda 6 vjet?	4	0	6
7. Kush e bënë kualifikimin e shkeljeve në të rënda apo të lehta?	1	0	9
8. Kush e themelon Komisionin Disiplinor?	9	0	1
9. Kush është shkalla e dytë ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor?	5	0	5

Prej pjesës së pyetjeve nga Rregullorja për Disiplinë rezulton se për shumicën dërrmuese të pyetjeve zyrtarët nuk kanë pasur njohuri bazike. Nga 10 zyrtarë të intervistuar, 9 zyrtarë kanë pasur njohuri se kush e themelon Komisionin Disiplinor, kurse 9 prej tyre nuk kanë pasur njohuri se kush është autoriteti i cili e bën kualifikimin e shkeljeve të lehta dhe të rënda në procedurë disiplinore.

Zyrtarët kanë shfaqur njohuri relativisht të saktë lidhur me shqiptimin e masave disiplinore, kurse lidhur me parashkrimin e afatit për shkeljet vetëm 4 zyrtarë janë përgjigjur në mënyrë të saktë.

¹⁰ Kodi i Etikës, neni 30, <https://kk.rks-gov.net/gjakove/ep-content/uploads/sites/2/2022/10/Kodi-i-Etikes-ne-Komunen-e-Gjakoves.pdf>

Mungesa e trajnimeve për anëtarët e Komisionit disiplinor dhe mungesa e kompensimit shtesë për anëtarët e saj

Anëtarët e komisioneve disiplinore të Komunës së Gjakovës nuk i janë nënshtruar asnjë trajnimi lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës së Komunës, procedurave disiplinore të përcaktuara me rregulloret dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë, para se të përzgjidhen.

Sipas intervistës së realizuar nga me z. Kushtrim Brahimajn, anëtarët e Komisionit disiplinor pas përzgjedhjes janë trajnuar përmes një trajnimi dyditor nga IKAP.

Po ashtu, zyrtarët që shërbejnë si anëtarë të komisioneve disiplinore nuk kompensohen për punën e tyre si anëtarë të komisioneve e kjo edhe sipas z.Kushtrim Brahimaj.

Rekomandimet:

- Komuna e Gjakovës të ndryshojë Kodin e Etikës dhe të përcaktojë procedura për trajtimin e rasteve disiplinore ndaj të zgjedhurve dhe të emëruarve politikë dhe stafit të tyre mbështetës;
- Komuna e Gjakovës të ndryshojë Kodin e Etikës, saktësisht të fshijë paragrafin 2 të nenit 5 të Kodit të Etikës, me të cilën dispozitë synohet të detyrohen zyrtarët politikë të mos ndërrojnë partinë e tyre;
- Komuna e Gjakovës të ndërtojë fushata vetëdijesuese me qëllim të njoftimit të qytetarëve të Komunës rreth Kodit të Etikës dhe procedurave disiplinore, të cilave mund t'iu nënshtrohen zyrtarët komunalë me qëllim të rritjes së numrit të ankesave të qytetarëve;
- Komuna e Gjakovës të vazhdojë të zhvillojë programe trajnimi të vazhdueshme për zyrtarët komunalë lidhur me Kodin e Etikës dhe procedurat disiplinore;
- Komuna e Gjakovës të zhvillojë trajnime me zyrtarët komunalë me qëllim të përditësimit të njohurive lidhur me vendimmarrjen në situata të konfliktit të interesit dhe konfliktit të interesit në përgjithësi;
- Komuna e Gjakovës të zhvillojë programe trajnimi dhe vlerësimi me zyrtarët komunalë rreth procedurave disiplinore;
- Komuna duhet të organizojë takime të rregullta periodike për të vlerësuar zbatimin e Kodit;
- Komuna e Gjakovës në bashkëpunim me IKAP të vazhdojë të zhvillojë programe për trajnimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore;
- Komuna e Gjakovës të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve komunalë në drejtim të instrumenteve për parandalimin e korrupsionit;
- Komuna e Gjakovës të ndërtojë modalitete për mbikëqyrjen e cilësisë së punës, në veçanti politikën ndëshkimore disiplinore të komisioneve disiplinore;

Kjo analizë është përgatitur nga BIRN-i përmes mbështetjes nga Aktiviteti i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për Integritetin e Komunave të Kosovës. Pikëpamjet e paraqitura në këtë artikull nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.